



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXIV-të (tridhjetë e katër – mandati VI) e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 25 maj 2021

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Mefail Rama, ndërsa mungoi Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Avni Sylja nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSh, Bashkim Bajrami nga Policia Rajonale Kufitare dhe Marvo Dusa përfaqësues i KFOR.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i falënderuar për pjesëmarrje në këtë mbledhje, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje e keni marr me kohë dhe keni mund të përgatiteni për këtë mbledhje, andaj mund të vazhdojmë me rendin e ditës, nëse nuk keni diçka për të shtuar unë e hedh në votim.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete të mbajtur më 19 prill 2021

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim – ndryshime u miratua Procesverbali sipas kësaj pike.

2. Informatë rreth vizitës së anëtarëve të Komitetit për Komunitete në lagjet ku jetojnë Komuniteti jo shumicë në territorin e Komunës së Podujevës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, bazuar në Planin e punës së Komitetit, për muajin maj kemi pasë të planifikuara dy vizita në terren, ne me disa anëtar të Komitetit për Komunitete kemi vizituar dy lagje (lagjen “Xhafer Meta” dhe “Ali Ajeti” ku jetojnë familje të Komunitetit jo shumicë) dhe jemi munduar t’i marrim të gjitha ankesat, kërkesat dhe t’i evidentojmë nevojat e Komunitetit që jetojnë në lagjet e cekura, pra jemi munduar t’i specifikojmë disa prej kërkesave më të arsyeshme.

Në lagjen “Ali Ajeti” ku edhe jeton Xhafer Ademi si përfaqësues i lagjes, kërkesë e tyre është ndërrimi i gypit të ujit që është azbest, rregullimi i Qendrës Rinore, punësimi sezonal dhe rregullimi i një pusete në atë lagje, ndërsa përveç gjendjes së rëndë ekonomike që përballen

familjet në atë atë lagje ku shumica prej tyre janë në skemën sociale, kërkesë e tyre ka qenë edhe punësimi, mirëpo jemi në dijeni se me çështjen e punësimit jemi duke u ballafaquar të gjithë jo vetëm komunitetet.

Sa i përket vizitës në lagjen “Xhafer Meta” kërkesë e banorëve ka qenë rregullimi i kanalizimit në atë lagje, punësimi, dhe rihapja e qendrës për aftësim në shkollën “DR Ibrahim Rugova” .

Pra këto që i ceka kanë qenë disa prej kërkesave më kryesore të dy lagjeve të cekura, andaj meqë prezent në këtë mbledhje është edhe zyrtari nga DSHPMSH, mund ta merr fjalën dhe të na jap sqarime shtesë rreth kërkesave në fjalë.

z.Avni Syla, zyrtar nga DSHPMSH, theksoi, lidhur me kërkesat dhe çështjet e paraqitura në dy lagjet e cekura ku jetojnë komunitetet jo shumicë mund t’ju them se janë bërë investime në fusha të ndryshme.

Sa i përket lagjes “Ali Ajeti” kemi kërkesë për ndërtimin me kubëza të 4 rrugicave, pastaj kemi kërkesë për ndërrimin e gypit të ujit, kërkesë për asfaltimin e rrugës me gjatësi 350m, ndërsa sa i përket rregullimit të kanalizimit në rrugën “Xhafer Meta” në vitin e kaluar është bërë ndërrimi i komplet gypit të ujërave të zeza, me përjashtim (sa jam i informuar) të një familjeje e cila nuk është lejuar nga një familje tjetër afër aty, të kyçet në rrjetin e kanalizimit, përndryshe në atë pjesë gypi është ndërruar sepse kemi pasë kërkesë edhe më parë për këtë çështje.

Sa i përket ndërtimit të rrugëve dhe rrugicave me kubëza zakonisht këtu rrugica mbeten në atë gjendje për shkak të pamundësisë së asfaltimit të tyre sepse makineria në disa pjesë nuk mund të hyjë dhe për këtë arsye për vitin e ardhshëm kemi planifikuar që në rrugët ku teknikisht nuk mund të ndërhyhet me asfalt ato rrugë të ndërtohen/shtrohen me kubëza, pra për vitin e ardhshëm janë të parapara që të përfundoher edhe këto projekte.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, vlen të theksohet kërkesa ndoshta më e arsyeshme që ishte në lagjen “Ali Ajeti” që ishte për ndërrimin e gypit të ujit të pijes, andaj a mund të na informosh edhe për këtë kërkesë.

z.Avni Syla, zyrtar nga DSHPMSH, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se çështja e ujit të pijes është më shumë çështje e Ujësjetës, por pavarësisht kësaj edhe ne si Komunë kemi një kod buxhetor për riparimin dhe mirëmbajtjen e gypave të ujit, dhe në këtë vite parashihet hartimi i një projekti për çështjet të cilat parashihen të kryhen me projekte e që kanë të bëjnë me kanalizimet, ujërat fekale, ndërrimi dhe riparimi i gypave të ujit dhe të tjera të ngjashme, do të thotë si përkrahje për Ujësjetësin, përndryshe ndërrimi i gypit është kompetencë e Kompanisë së Ujësjetës Rajonal, mirëpo edhe përkundër kësaj ne si komunë e kemi marrë përsipër edhe këtë çështje.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit për Komunitete, theksoi, falënderoj zyrtarin parafolës për informatat e dhëna, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Të ndryshme

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0041681/21

Podujevë, 25 maj 2021

Kryesuese e Komitetit

Albina Avdiu